REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

***Draft***

**Nr______Prot** **Vau Dejës me _____/______2020**

**VENDIM**

Nr. 70 Datë 26.11.2020

**Për dhënien e dakordësisë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi kullosor publik për mbjellje vreshte organike nga Shkolla e mesme Profesionale "Ndre Mjeda" Bushat në bashkëpunim me shoqatën COSPE.**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja "e/1" (ndryshuar), neni 55 pika 4, tr ligjit nr 139/2015 date 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" , Ligji nr 38/2019, Ligji nr 8744 datë 22.02.2001, "Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore", ndryshuar, Ligjin nr 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shteterore dhe enteve publike", Ligjin nr 107/2014 date 31.07.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ne Ligjin nr 10304 datë 15.07.2000 "Për sektorin minerar në Republiken e Shqipërise", ne VKM-në nr 68 dt 28.01.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Bushat të Qarkut të Shkodres", ndryshuar me VKM nr 246 dt 31.03.2911, "Për disa ndryshime në VKM nr 68 dt 28.01.2008, në VKM nr 592, dt 09.10.2018, "Për disa ndryshime në VKM nr 1374, date 10.10.2008, "Për përcaktimin e rregullave dhe te procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor", udhëzimin e ministrit te mjedisit nr 1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënje në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", si dhe pas shqyrtimit te **Projekt Vendimit nr 03, datë 14.10.2020, "** Për miratimin e vazhdimit te procedurave për ndryshimin e destinacionit dhe heqjes nga fondi kullosor të sipërfaqes prej 1000m2, ndodhur në Zk nr 1329, me nr Pasurie 80/4, pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të cilësuar të votave, Këshilli Bashkiak,

**VENDOSI:**

1. Të shprehë dakordësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi kullosor publik, për mbjellje të Vreshtës Organike, të sipërfaqes prej 0,1 Ha, në nr e pasurisë 80/4, në Zonën kadastrale nr 1329, të Bashkisë Vau Dejës.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurimeve dhe Integrimit, Sektori i Aseteve.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite mbas shpalljes publike ( sipas percaktimeve të nenit 55, pika 6, te Ligjit nr 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

**ZV/K R Y E T A R**
_Ervis SHIMAJ_______________________
Sekretari i Këshillit Bashkiak
_Ardian ÇELEPIJA_______________________
Miratuar me __19__vota
Vota Pro__19__
Vota Kunder__–__
Vota Abstenim__–__
Zbardhur me date__02.12.2020__

Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vaudejes.gov.al

Bashkia Vau Dejës *Shtojca nr 1*

**RAPORT TEKNIK**

MBI GJENDJEN FAKTIKE DHE LLOGARITJEN E SIPERFAQES SE PASURISE SE LLOJIT KULLOTE NE PRONESI TE BASHKISE

Bazuar në kërkesën e Shkollës së mesme Profesionale "Ndre Mjeda" Bushat, si dhe në urdhërin e kryetarit të Bashkisë me nr 331, dt 17.11.2020, "Për përcaktimin e siperfaqes që kërkohet për mbjellje vreshte organike nga shkolla e mesme profesionale"Ndre Mjeda" Bushat", grupi i punës realizoi verifikimin e gjendjes faktike të pronës dhe matjet e sakta në terren, duke përcaktuar pjesen e sipërfaqes që kërkohet ndryshim sestinacionitë merret në shfrytëzim,

Nga verifikimi i gjendjes faktike dhe matjet në terren rezulton se:

- Sipërfaqja e tokes, është pronë publike e Bashkise Vau Dejës, e llojit Kullotë, ndodhur ne Zk nr 1329, me nr Pasurie 80/4, me çertifikatë pronësie nr 407052 date 13.09.2011 ne favor te komuna Bushat.
- Sipërfaqja kufizohet në Veri pasuria nr 80/5, Jug 85, 818/4, Lindje 818/4, Perendim 85.
- Sipëfaqja e pronës që kërkohet të merret në shfrytëzim eshte pjese e kesaj pasurie me SIP = 0.1 Ha.
- Koordinatat e sipërfaqes janë të vendosura në plan rilevim.

Bashkëngjitur , kopje e çertifikatës së pronësise për pasurinë 80/4, plan rilevimi i pjesës që kërkohet për ndryshim destinacioni.

Grupi i Punes

Ndoc Baqli Esmeraldo Harapi Aldo Game

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU I DEJËS
SEKRETARIA

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

# ÇERTIFIKATË

## PËR VËRTETIM PRONËSIE

407052

Zyra e Regjistrimit SHKODER Zona Kadastrale Nr. 1329

Numri i Pasurisë 80/4 Volumi 9 Faqe 53

Adresa e Pasurisë BUSHAT - SHKODER

Lloji i Pasurisë KULLOTE

Sipërfaqja Totale 2262 m² (DYMIJE E DYQINDE E GJASHTEDHJETE E DY) m²

Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

### KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| KOMUNA | | BUSHAT | I | BUSHAT |

- është pronar i PASURISE ME NR. 80/4
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart -
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi -
- kufizimet e pasurisë janë : V 80/5, L 818/4, J 85, 818/4, P 85

**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t)** me datë 13.09.2011 Nr. 374

Data e lëshimit të çertifikatës

13.09.2011

Lëshuesi i certifikatës
REGJISTRUESI
( NERHAN KALAMISHI )

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
Z.V.R.P.P.
SHKODER

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

*(Fragment)*

| ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJSHME | A. IDENTIFIKIMI I PASURISE |
|---|---|
| SHKODER | ZONA KADASTRALE 1329 NR. I PASURISE 80/4 VOL. 9 FQ 53 |
| ING. G. TERNAVA | INDEKSI I HARTES K-34-76-(2-C) SHKALLA 1:2500 |
| | ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER Q/F BUSHAT |
| | Rr/L ______ P/G ______ Sh ______ K ______ Ap ______ |
| | **B. KUFIZIMET** — V. 80/5; L. 818/4; J. 85, 818/4; P. 85 |
| | **C. PRONARI** — KOMUNA "BUSHAT"; S = 2262 m2 |
| *Vula.* | D. Data: 13/9 2011, Ora: ______ |



# PLAN RILEVIM

| PERGATITI | IDENTIFIKIMI I PASURISE |
|---|---|
| Emri mbiemri: HAMID ÇULIQ | ZONA KADASTRALE : 1329 |
| Licensa Nr. T-0675/2 date 10.04.2018 | NUMRI I PASURISE : 80/4 VOL. 9 FQ. 53 |
| Data e pergatitjes: 02.12.2020 | INDEKSI I HARTES : K - 34 - 76 - (2 - C) |
| Siperfaqe: S=2262 $m^2$ | SHKALLA : 1:2500 |
| Ndarje pasurie:<br>S1=1262 $m^2$<br>S2=500 $m^2$<br>S3=500 $m^2$ | ADRESA E PASURISE:<br>Fshati Bushat Rrethi Shkoder |
| ING. TOPOGRAF<br>HAMID ÇULIQ<br>NR LIÇENSE-T0675/2<br>Vula Firma | POROSITES : BASHKIA VAU DEJES |

V

J

